VENDIM
Nr.78, datë 8.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.12.2005, pasi shqyrtoi, për fillimin e procedurave, kërkesën e shoqërisë "Wonder Power" sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006, për shoqërinë "Wonder Power" sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe plotësimin e praktikës së aplikimit në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema